



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), nenit 24, paragrafët 1, 2, dhe nenit 25, paragrafët 1, 2, dhe 6 të Ligjit nr. 06/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 10/03, prill 2019), në bazë të nenit 29, të Rregullores nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme dhe në bazë të nenit 33.2, shkronja a, dhe nenit 34.1, shkronja d, të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 04.09.2023, merr këtë

V E N D I M

PËR PLOTËSIM-NDRYSHIMIN E VENDIMIT, NR. 01-462/01-134225/23, TË DT. 29.06.2023, PËR KËMBIMIN E PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME PRONËN E PALUAJTSHME NË PRONËSI PRIVATE

- I. **MIRATOHET** Vendimi për plotësim-ndryshimin e Vendimit, nr. 01-462/01-134225/23, dt. 29.06.2023, për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën e paluajtshme, në pronësi të Nazmi (Ruzhdi) Fetahut dhe Magbule (Shahin) Sadrisë.
- II. Sipas pikës I të këtij vendimi, plotësim - ndryshimi nënkupton:
 1. Ndryshohet zona kadastrale, hiqet zona kadastrale Prishtinë, paraprake, për parcelën kadastrale nr. 363-0, me sipërfaqe prej 1198m² Zona kadastrale Prishtinë, në pronësi të Magbule (Shahin) Sadrisë, të shtohet Zona kadastrale Sofali - Prishtinë, me formën e re, për të njëjtën parcelë, nr. 363-0, me sipërfaqe prej 1198m².
 2. Propozimi për inicimin e plotësim-ndryshimit të Zonës kadastrale të cekur në pikën II, është bërë pasi që në Vendimin paraprak, nr. 01-462/01-134225/23, të dt. 29.6.2023, është lëshuar një gabim teknik në Zonën kadastrale për parcelën kadastrale nr. 363-0, Zona kadastrale Sofali - Prishtinë, të propozuar për këmbim.
- III. Këmbimi i pronës së paluajtshme është bërë për shkak të realizimit të Planit rregullues "Muhaxhirët", i miratuar sipas Vendimit, nr. 01, nr. 35-1299, të dt. 29.6.2010.
- IV. Para shpalljes publike të vendimit, do të bëhet vlerësimi i kualifikuar i vlerës së tregut të pronës së paluajtshme të Komunës dhe vlerësimi i pronës private, ku do të përcaktohen sipërfaqet e sakta të këmbimit.
- V. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbëhet.

VI. Pronat e paluajtshme komunale që do të këmbehen, të përshkruara në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohen në librat kadastrale të Komunës.

VII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtorja e Pronës dhe Drejtorja e Kadastrit e Komunës së Prishtinës.

VIII. Pjesë përbërëse të këtij vendimi janë:

- skica grafike,
- kopjet e planit dhe
- certifikatat e njësisë kadastrale.

IX. Ky vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-463/06-183676/23, më 05.09.2023

KRYESUESI I KUVENDIT

Pëllumb Bajramov



A r s y e t i m

Kuvendit të Komunës së Prishtinës, më 10.05.2023, i kemi bërë propozimin për këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës me pronën private.

Drejtoria e Pronës, gjatë përgatitjes së materialeve, ka vërejtur se është bërë një gabim teknik në zonën kadastrale për parcelën kadastrale të propozuar për këmbim.

Andaj, kërkohet të bëhet plotësim-ndryshimi i zonës kadastrale për parcelën nr. 363-0, pika II. e propozimit gabim, i cili është vërejtur nga Drejtoria e Pronës, duhet të përmirësohet, të hiqet Zona kadastrale Prishtinë, paraprake, e parcelës nr. 363-0, Zona kadastrale Prishtinë, pronë e Magbule (Shahin) Sadrisë, dhe në vend të saj duhet të jetë Zona kadastrale Sofali – Prishtinë, me formën e re, për parcelën kadastrale, nr. 363-0, sipërfaqe prej 1198m².

Andaj, duke u bazuar në dispozitat ligjore të cilat janë të përshkruar në pjesën hyrëse të këtij Propozimi dhe në shkresat e lëndës, propozojmë që të bëhet plotësim-ndryshimi i skicës sipas pikës I të dispositivit të këtij propozimi.